

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština –Municipality  of Prishtina</p>	
---	---	---

<b>Datë/a:</b>	04.09.2018
<b>Për/ Za/ To:</b>	NTSH MARIMANGA
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 31.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “NTSH MARIMANGA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Shërbimet e transportit me marimangë**”, me Nr. të Prok: **616 18 4235 211** nxjerr:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik “NTSH MARIMANGA”, të dt. 31.08.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Shërbimet e transportit me marimangë**”, me Nr. të Prok: **616 18 4235 211**, kundër **vendimit të Autoritetit Kontraktues**, të datës **27.08.2018** të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet vendimi i AK** për dhënien e kontratës të publikuar me datë: **27.08.2018**.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 08.06.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimiti: “**Shërbimet e transportit me marimangë**”, me Nr. të Prok: **616 18 4235 211** , procedura e hapur.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 16.07.2018. Janë dorëzuar gjithsejtë 4 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të tenderëve.

Me datë 27.08.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit të prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

OE “**NTSH MARIMANGA**”, me dt. 31.08.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Shërbimet e transportit me marimangë**”, me Nr. të Prok: **616 18 4235 211** , kundër vendimit të AK , në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

*Neni 58: Hapja e tenderëve*

*Neni 73: Dispozitat e pergjitheshme te Ligjit*

*Neni 19: Ndarja e kontratave ne Lote i Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik*

*Neni 32: Dorezimi i tenderit ne forme fizike i Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik*

*Neni 45: Formularet Standard i Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik*

### **I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.**

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon OE “**NTSH MARIMANGA**”, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e tenderëve ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 58: Hapja e tenderëve** - sipas këtij neni te gjithë tenderët që dorëzohen para afatit te fundit kohor per dorëzimin e tenderit do të hapen në vendin dhe kohën e caktuar në dosje të tenderit. AK ka bere hapjen me perputhje me këtë Nen. Gjej të bashkangjitur Regjistrin e ofertave te dorezuara i cili deshmon se oferta eshte dorëzuar në afatin kohor. Gjithashtu edhe sqarimin e datës 18.08.2018 të cilin e keni pranuar në lidhje me këtë qështje.

2. **Neni 73: Dispozitat e pergjitheshme te Ligjit** - Ky nen nuk ka te beje me aktivitetin e cekur ne fjale. Ky nen i referohet Konkurseve te projekteve.

Mengjithate AK sqaron se nese kerkesa per rishqyrtim ka te beje me kriteret e percaktuara ne dosje te tenderit, kerkesa e tille duhet te dorezohet 5 dite para afatit te fundit per dorezim te tendereve, NENIN 108A.3.1.

AK hedh posht pretendimin tuaj sepse Kerkesa ka qene shume e qarte te Dosje te tenderit. Shih me poshte.

***“KERKESA: Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka minimum 2 vozitës dhe 2 ndihmës – që kanë patentën e shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës.***

***DESHMIA:***

***Kopja e patente shoferit dhe kontrata e punës ose para-kontratës”***

Gjithashtu ju keni mundur te beni pytje ne perputhje me nenin 53 te LPP-se per qfardo paqartesie.

3. **Neni 19: Ndarja e kontratave ne Lote i Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik-** AK hedh posht pretendimin tuaj sepse kjo eshte bere ne perputhje me nenin 19.4 te rregullave dhe udhezuesit operativ i cili percakton *“19.4 Nisur nga fakti, se qëllimi i kufizimit të numrit të Loteve është që të rritet konkurrenca dhe, në mënyrë që të lejohet qasje maksimale për fondet publike, të ndahet tregu në mesin e numrit të madh të operatorëve ekonomik, kjo dispozitë është e aplikueshme vetëm kur ka tender të mjaftueshëm të përgjegjshëm për të aplikuar këtë rregull. Kur nuk ka tender të përgjegjshëm të mjaftueshëm për të shpërblyer të gjitha Lotet mbizotëron interesi i AK që të shpërblej të gjitha Lotet. Pra, në mungesë të konkurrentëve të tjerë, OE shpërblehen për më shumë Lote se sa numri maksimal i përcaktuar nga AK.”*
4. **Neni 32: Dorezimi i tenderit ne forme fizike i Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik-** hedh poshte pretendimin tuaj duke u bazuar ne ate qe u tha me larte -PRETENDIMIT DHE ARSYETIMIT NR.1
5. **Neni 45: Formularet Standard i Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik -** hedh poshte pretendimin tuaj duke u bazuar ne ate qe u tha me larte- PRETENDIMIT DHE ARSYETIMIT NR.2

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized first letter 'P' followed by a series of loops and a horizontal line at the end.

## Prokurimi Prishtine

---

**From:** Zeke Bardhaj  
**Sent:** 18 July, 2018 14:49  
**To:** marimanga2007@hotmail.com; Prokurimi Prishtine  
**Subject:** Pergjegja ne ankese  
**Attachments:** Pergjegje per Marimangen.PDF; REGJISTRI I TENDEREVE TE PRANUAR.PDF; Raporti hapjes.PDF

Te nderuar,  
Ua percjell pergjegjen ne baze te ankeses te OE-ik "Marimanga".

Me respekt,

Zekë Bardhaj  
Udhëheqës i Prokurimit  
Kabineti i Kryetarit  
Komuna e Prishtinës

e-mail: [zeke.bardhaj@rks-gov.net](mailto:zeke.bardhaj@rks-gov.net)  
tel: +381 (0)38 224 869  
mon: +377 (0)44 360 660



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	18 .07.2018
Referenc-ë:	Ankesa nr.14-370/01-0171-433/18
Për/ Za/ To:	OE-ik "Marimanga"
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj ,Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pergjegje ne ankesë



I nderuar,

Ankesa juaj është drejtuar gabimisht në Departamentin e Prokurimit,pasiqë pretendimet e paraqitura nuk kanë të bëjnë me këtë shërbim.

Zyra pritëse është e autorizuar për pranimin e të gjitha kërkesave,që d.t.th.edhe për pranimin e tenderëve që dorëzohen në formë fizike.Evidentimi i tenderëve të pranuar bëhet në formularin zyrtar:Regjistri i tenderëve të dorëzuar,në të cilin shënohen emri i tenderuesit,data dhe ora e dorëzimit të tenderit,numri fiskal dhe nënshkrimi i dorëzuesit të tenderit.

Lidhur me tenderin që ju keni pretendime ju sqarojmë se në regjistrin e tenderëve të dorëzuar janë regjistruar katër tender dhe të gjithë në afatin e paraparë-deri në orën 14:00.

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara edhe për faktin se ju personalisht keni marrë pjesë në hapjen publike dhe nuk keni reaguar lidhur me pretendimet tuaja,edhe pse në hapje publike janë lexuar çmimet e katër tenderueseve dhe poashtu në raportin e hapjes nuk keni shënuar asnjë vërejtje.Pse pretendimet tuaja i paraqitet pas hapjes është çështja e juaja dhe mund t'i drejtoni në Institucione tjera.

Bazuar në arsyet e paraqitura më lartë këtë ju njoftoj se ankesa juaj sa i përket procedurës së prokurimit,respektivisht dorëzimit dhe hapjes së tenderëve është e pa bazuar.



Shtojcë:

Regjistri i tenderëve të dorëzuar dhe  
Procesverbali i hapjes së tenderëve

16. 07. 2018

**REGJISTRI I TENDERËVE TË DORËZUAR / TENDER SUBMISSION RECORD / REGISTAR  
PRIMLJENIH TENDERA**

<b>Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:</b>	616 18 4235 211 616 18 069 211	<b>tulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru</b>	Shërbimet e transportit me maritim
--	-----------------------------------	--	------------------------------------

Nr. Br.	Tenderuesi <sup>2</sup> Tenderer Name Tenderer	Pranimi i tenderit / Tender Reception / Prijem tendera			Nënshkrimi i dorëzuesit të tenderit Tender Deliverer's Signature Potpis dostavljača tendera
		Data Date Datum	Ora Time Čas 14:00	Numri Fiskal I OE dhe të gjithë anëtarëve të konzorciumit.	
1	V.2 COMPANY JPR	16.07.18	13 <sup>15</sup>	600039011	
2	NTSH MARIMANGA	16.07.2018	13 <sup>50</sup>	600032396	
3	NTSH BEGA-LONJ	16.07.2018	13 <sup>51</sup>	600002660	
4	DRENI-A SH.P.K	16.07.2018	14:00	600007528	
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					

<sup>1</sup> Udhëzim për zyrtarin pranues të AK – shkruani dallueshëm numrin përkatës nga kjo listë në secilin zart/pako. Nënshkruani, në kutinë përkatëse, për pranimin e çdo tenderi. Merrni nënshkrimin e çdo dorëzuesi të tenderit në kutinë përkatëse / **Instruction to CA's reception officer** - write remarkably the respective number from this list on each envelop/parcel. Sign in the corresponding cell, for each tender reception. Get the signature of each tender deliverer in the corresponding cell/**Instrukcija za službenika prijema UA**- navedite jasno odredjen broj sa ove liste na svakom kovertu/paketu. Potpišite, u odredjenoj kutiji, prijem svakog tendera. Svaki predavač tendera neka se potpiše na odredjenoj kutiji.